

ARBEN KALLAMATA

HIJET E MUZGUT

ROMAN

BOTIMET TOENA

ARBEN KALLAMATA

HIJET E MUZGUT

roman

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2019

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktor: Kujtim Dashi

Korrektore letrare dhe përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-56-5

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

Botimet TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

Muzg është koha midis ditës dhe natës, hapësira e mistershme kohore, kur sapo perëndon dielli dhe s'ka ardhur ende errësira e plotë, ose kur territ po ia shqyen perden afrimi i ditës së re. Në qiellin e muzgut shfaqet ylli i parë, ylli i mëngjesit, ose ylli i mbrëmjes, Afërdita ose drita e natës që vjen më afër ditës.

Afërdita është ylli, që i ka mahnitur njerëzit në përjetësi, për sa kohë kanë qenë në gjendje të mendojnë dhe të shikojnë qiellin. I ndritshëm si yll, pa qenë yll, as me ditën dhe as me natën, edhe me ditën edhe me natën, herë në formën e një perëndeshe, herë në formën e një bukurie të rrallë njerëzore, ajo i takon më tepër se kujtdo muzgut, duke mbetur e pakapshme, e paprekshme, e pakuptueshme. Thelbësisht e dyzuar midis mëngjesit dhe mbrëmjes, Afërdita vazhdon t'i torturojë mendjet e njerëzve.

- O yll i magjishëm! A je lajmës i natës së errët që vjen, apo i ditës së ndritshme që agon?

- Kush po pyet?

Mimat -Viruset e Mendjes

Mimë (anglisht *meme*) është fjalë e krijuar nga Richard Dawkins në librin “The Selfish Gene” (“Gjeni vetjak”, 1976) si përpjekje për të shpjeguar përse disa sjellje të caktuara, që nga këndvështrimi zhvillimor duken pa kuptim, arrijnë të zënë vend dhe të bëhen të rëndomta në shoqëri. Dawkins thekson se përzgjedhja natyrore është gjykatëse e pafalshme e subjekteve të veta, ndaj çdo shenjë dobësie fizike apo në sjellje, ndëshkohet me dëbim nga pellgu i përbashkët i gjeneve. Pra, logjikisht pritet që mënyrat e sjelljeve, që mbizotërojnë një shoqëri në zhvillim, pavarësisht sa të pashpjegueshme të duken, të ndihmojnë në mbijetesën e gjeneve. Kërkimet e vazhdueshme, për të kuptuar arsyet, mënyrën se si sillen kafshët e ndryshme kanë dhënë përfundime që pajtohen plotësisht me këtë tezë.

Megjithatë, ka raste kur del e nevojshme të rrëmohet pak më thellë, për të kuptuar se kush saktësisht përfiton nga sjellje të caktuara. Më librin “Prishja

e magjisë” - 2006, Daniel Dennett sjell shembullin e milingonave, që ngjiten në majë të fijeve të barit, duke u munduar të qëndrojnë atje, në një pikë që i ekspozon dhe i bën ato pre të kafshëve barngrënëse. Është e pamundur ta shpjegosh këtë veprim vetëvrasës me përparësinë që i jepet milingonës për të mbijetuar. Mirëpo, po të vesh re me kujdes, do të zbulosh se nuk është milingona ajo, që përfiton prej këtij veprimi vetëvrasës, por një mikrob i vogël, që ka arritur të depërtojë në trurin e saj dhe e detyron atë të sillet në atë mënyrë. Cikli riprodhues i kushtëzon mikrobit nevojën që të kapërdihet nga kafshë të mëdha si delet apo lopët. Një nga mënyrat për ta arritur këtë është duke hyrë në trurin e milingonave dhe duke i çuar ato drejt vetëvrasjes. Në të njëjtën mënyrë përfitojnë edhe viruset nga mënyra se si sillen bartësit e tyre. Rastet kur një organizëm shfrytëzon ose manipulon sjelljen e një tjetri për përfitim gjenetik janë të shumta.

Duke u thelluar në këto vëzhgime dhe zbulime Dawkins shpjegon se si ndodhin procese të ngjashme edhe me njerëzit. Për shembull, disa ide që në plan të parë duken sikur janë të dëmshme për njerëzit që i mbajnë, vazhdojnë të mbijetojnë dhe të përhapen. Kështu, përkushtimi ndaj artit deri në sakrificë, shkatërrimi i vetes në kërkim të të vërtetës, martirizimi për një kauzë të caktuar si patriotizmi nuk janë praktika, që duket sikur ndihmojnë përhapjen e gjeneve të individëve që i mbartin. Meqë sjellje të tilla ekzistojnë dhe janë të përhapura del e nevojshme

të përcaktohet se kush përfiton prej tyre. Në mënyrë befasuese Dawkins arrin në përfundimin se nuk janë njerëzit ata që përfitojnë, por janë vetë idetë. Idetë konkurrojnë me njëra-tjetrën dhe, ndoshta midis tyre zhvillohet një proces përzgjedhje, i ngjashëm me përzgjedhjen natyrore, përmes të cilit disa prej ideve kanë sukses dhe shpërndahen, ndërsa të tjera zhduken. Dawkins arrin në përfundimin se një përzgjedhje e tillë ekziston dhe, për të theksuar paralelizmin me përzgjedhjen natyrore ai krijoi fjalën mimë, që vjen nga greqishtja e vjetër “mimeme” dhe do të thotë diçka e imituar. Mimat janë “viruse të mendjes”, të cilat ashtu si edhe viruset e trupit, shpërfillin krejtësisht interesat e bartësve të tyre. E vetmja gjë me rëndësi për to është që të mbijetojnë vetë.

Helena

“Nëse hetojmë prejardhjen e fjalës “Hellas” do na çojë dhe kjo se helenët nuk vijnë nga Jugu, siç thotë Kordati, por nga Iliria.

Studiues... e nxjerrin prejardhjen e “Hellas” nga rrënja pellazge “el-” që do të thotë ose ndoshta ka kuptimin e lartësisë dhe e hasim në një numër të konsiderueshëm toponimesh të botës pellazge, që nga Italia Qendrore deri në Azi të Vogël.

Po nga kjo rrënjë prodhohen edhe fjalët Helope dhe Helopi, helinë dhe Alauinë (Albanë + shqiptarët), Iliria dhe ilirët, d.m.th., të lartë, ose nga lart, d.m.th. malor, Ilia = vend malor, Heluite (helvetët nga Helvetia, pra zviceranët) Ilea që ishte gjykata e lartë në Athinë, Alia që ishte Kuvendi Popullor në qytetin dorian etj., dhe Ilion dmth Troja vjen nga e njëjta rrënjë dhe me të vërtetë ndodhet “mbi një kodër të lartë me sipërfaqe të madhe dhe me dy maja në rrëzë të saj shtihet në fushë pjellore”. Me këtë etimologji bie dakort edhe gjeografi i lashtësisë, Stavroni.

Që ta mbyllim çështjen do të rikthehem se në Arbërisht kemi fjalën i lartë ose ilia. Pra sipas këtij vesioni etimologjik Hellad do të thotë (vend) malor dhe helenë = malësorë.

Në të vërtetë ky version etimologjik përveç mbulimit gjuhësor ka edhe mbështetje kuptimore. Zona përreth Dodonës dhe Akeloit është në fakt zonë malore. Bie dakord me dëshminë e Homerit se Greqia me gratë e bukura është vendi që ndodhet pranë Fthias së Akilit, akziston zoti lumenjëve dhe lumi me të njëjtën rrënjë me Akilin, pra, Akeloi, ekzistojnë vendosje të ngjashme të popujve malësor në të njëjtën rrënjë. Së fundi mbulimi gjuhësor bëhet nga gjuha pellazge, dhe së fundi këta helenë paraqiten si popull që gjendet në zemër të qytetërimit shpirtëror dhe fetar që ishte Dodona e Epirit.

Me faktin e emërimit të helenëve si malësor përjashtojmë në mënyrë automatike hipotezën se mund të kenë ardhur nga deti, apo Mesopotamia, apo Azia e Vogël. Ndodhi pikërisht e kundërta dhe të gjitha kërkimet e sotme i vulosin dëshmitë e djeshme, dmth. të helenëve të lashtë dhe mbështesin legjendat e lashtësisë dhe traditat që thonë se të gjitha fiset Helene erdhën nga Ballkani veriperëndimor.”¹

¹ Aristidh P. Kola, *Arvanitasit dhe Prejardhja e Grekëve*, Botimi shqip i vitit 2002, f. 97-98.

PJESA E PARË
PELLAZGËT

Në fillim

Koha: Fillimi i kohës

Në fillim fare Zoti krijoi qiellin dhe tokën. Toka ishte pa formë dhe e zbrazët, e mbuluar nga errësira dhe Shpirti i Zotit fluturonte përmbi ujëra. Por erdhi, më në fund, koha, kur Zoti tha: - Le ta ndriçojmë pak, - dhe, pas kësaj gjithçka u ndriçua dhe, Zoti e ndau dritën nga errësira duke e quajtur dritën “ditë” dhe errësirën “natë”. Kështu u krijua dita e parë. Pastaj Zoti tha: - Tani, le të ndajmë detin nga qielli, veprim ky që kushtëzoi ditën e dytë. Më tej Zoti u kujtua se kishte ardhur koha të ndante tokën nga uji, prandaj e quajti tokën e thatë “tokë” dhe tokën e njomë “ujë”, ose “det”. Zotit i pëlqeu kaq shumë kjo punë, sa që tha me vete: - Punë e paqme. Kështu mbaroi dita e tretë. Ditën e katërt Zoti iu kushtua bujqësisë, duke i dhënë mundësi tokës të rriste bimësi - barishte, pemë - frutore dhe jofrutore, halore dhe gjethore, shkurre, zarzavate, hithra, presh dhe hudhra.

Në ditët që pasuan Zoti vazhdoi të merrej me imtësitë, ta popullonte botën me kafshë nga më të ndryshmet, t'iu vinte emra dhe t'iu jepte fushën e përdorimit, të caktonte kush do të hante kë, dhe cili do të hante çfarë. Ai vendosi rregullat e ngrënies dhe sasinë e të ngrënit, shkallën e mekanizmit të vetëmbrojtjes dhe të aftësisë për të gjuajtur, shpejtësinë e të vrapuarit, lartësinë e të fluturuarit dhe thellësinë e të zhyturit. Me një fjalë e bëri botën siç ia donte qejfi - bëri qen që të ndiqnin macet; bëri ujç që të hanin delet dhe arinj që të trembnin ujçërit; bëri luanë dhe tigra që të hanin gazela dhe antilopa; bëri hiena që të hanin ushqimin që linin pa ngrënë luanët dhe tigrat; bëri peshq të mëdhenj që të gllabëronin më të vegjlit, pastaj bëri peshq edhe më të vegjël që të haheshin nga peshqit disi më të mëdhenj, e kështu me radhë deri te cironkat, krimbat, mizat; bëri mushkonjat që s'i hyjnë në punë as dreqit po vetëm sa iu ngrenë nervat të gjithëve; bëri midhje dhe zhaba, gjarpërinj dhe shpendë, zvarranikë e fluturakë.

Kur i mbaroi të gjitha Zoti u duk i kënaqur. Ama jo krejt i kënaqur. I kishte mbetur një copëz kënaqësie pa iu plotësuar. Zoti vuri re se i mungonte diçka. I mungonte diçka që t'i gëzonte të gjitha këto dhe, mbi të gjitha, t'i ishte Atij mirënjohës për çka kishte krijuar. Diçka që t'i lutej e t'i falej, t'i trembej e ta donte, dhe jo të vërtitej pa e çarë kokën për ekzistencën e tij, siç bënin kafshët dhe sendet e tjera.

- Më duhet diçka që të jetë në gjendje t'i vrasë dhe t'i hajë këto kafshë moskokëçarëse, - tha Zoti. - Më duhet dikush që t'i shkatërrojë këto pyje të bukura, t'i presë këto pemë të larta; ta prishë këtë ajër kaq të pastër; t'i ndotë këto ujëra të kulluara; t'i thyejë këta shkëmbinj kokëfortë; t'i nxjerrë nga nëntoka mineralet dhe naftën, që as unë s'e di përse i kam futur aq thellë; ta qelbë ajrin dhe ta turbullojë ujin; diçka që t'i bëjë të gjitha lëmsh. Dhe kjo diçka duhet bërë sipas shëmbëlltyrës sime.

Kështu Zoti krijoi njeriun. Jo një, po dy. Të ndarë dhe të pavarur nga njëri-tjetri. Të shkëputur me dete, oqeanë, kilometra malesh e kontinentesh. Njërin, e vuri në një kopsht të bukur, në Kopshtin e Edinit, me të gjitha të mirat, në mes të oqeanit, dhe e quajti Adam. Kopshti i Edinit ishte diku në një nga ishujt pranë bregut lindor të Afrikës.

Tjetrin e vuri në mes të disa maleve të bukura, zhytur në pyje të gjelbëruara dhe pemë të panumërta, në një tokë me dhë të kuqërremtë, në një kopsht të cilin e quajti "S'Edin". Njeriun e dytë e quajti Qygj. Kopshti i S'Edinit ishte diku në Ballkanin Jugperëndimor, në Europën Juglindore, pranë një lumi të vogël shkumues, që quhej Shkumbin, diku rrotull një pike që quhej Xhyrë.

Të dy njerëzit e parë ishin burra, pasi Zoti i krijoi sipas shëmbëlltyrës së tij dhe Zoti, dihet mirëfilli, që është burrë, me qime të ashpra dhe lesh në të katërta anët, me qoqe e me gjithçka tjetër që vjen me paketën

e një burri. Sepse Zoti mund të vijë në tri forma, si Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë, por që të tria format janë burra. Asnjë nga format nuk është grua. Prandaj edhe dy njerëzit e parë që u krijuan ishin burra, sepse Zoti ishte i vendosur t'i krijonte njerëzit e parë në shëmbëlltyrën e tij.

Të palidhur me njëri-tjetrin, të pavarur nga njëri-tjetri, mijëra kilometra larg njëri-tjetrit, Adami dhe Qygji jetonin nën vëzhgimin e kujdesshëm dhe të vazhdueshëm - por jo të pandërprerë të Zotit. Ata jetuan disa qindra vjet kështu, të vetmuar, pjesë e eksperimentit të Zotit, i cili përsëriste vazhdimisht me vete: - Punë e paqme! Zoti është tip që kënaqet me punën e tij.

Megjithatë, erdhi një ditë që edhe Ai, bashkë me dy njerëzit që kishte krijuar, u mërzitën. I pari u mërzit Adami. Ai iu drejtua Zotit:

- O Zot i madh, - i tha, - ndihem i vetmuar. Shikoj përreth dhe vë re se të gjitha kafshët që ke krijuar këtu në Kopshtin e Edinit e kanë nga një shok, nga një partner, me të cilin eglendisen: ujku kruhet pas ujkonjës; ariu polar ngjishet pas arushës polare (sepse në Kopshtin e, Edinit pavarësisht nga klima, rronin të gjitha llojet e kafshëve); qentë ua hipin gjithë qejf buçeve. Vetëm unë s'kam me kë të gërvëlisem. Ata lindin kalamaj e shumohen, kurse unë kam mbetur firar.

Zoti kroi kokën dhe i dha të drejtë.

- Jam i një mendimi me ty, - tha Ai. - Ty të duhet një njeri, domethënë njeri femër. Unë ta bëj, por duhet të të heq një kockë. Le të themi një brinjë.

- Po unë mezi i kam brinjët dhe më duhen për të mbajtur kafazin e kraharorit, - ia ktheu Adami.

- S'ka problem, - ia mbushi mendjen Zoti. - Kafazi i kraharorit mund të rrijë për bukuri edhe me një brinjë mangët. Unë kaq e kam pazarin, një brinjë. Po të duash merre, po të duash lëre.

Adami pranoi dhe Zoti i hoqi atij një brinjë nga kafazi i kraharorit. Megjithëse Zoti i hoqi një brinjë, Adami mbeti me numër të plotë brinjësh dhe kjo s'u mor vesh kurrë sesi ndodhi. Ja, këto janë mrekullitë e Zotit, që mendja e gjorë njerëzore nuk është në gjendje t'i shpjegojë. Se Zoti, që di të shkuarën, edhe të sotmen, edhe të ardhmen, do ta ketë ditur që një ditë prej ditësh Adami do t'i kërkonte t'i krijonte ndonjë shoqe nga brinja, prandaj kur e krijoi fillimisht atë e bëri me brinjë të plota, ndoshta edhe me një brinjë shtesë, të cilën po t'ia hiqte, do t'i mbeteshin përsëri të plota, por edhe kur s'ia kishte hequr, përsëri ishin të plota. Punët e Zotit janë tepër të ndërlikuara dhe duhen marrë me besim, jo me arsyetim logjik.

Pasi hoqi brinjën, Zoti kreu një përpunim gjenetik duke krijuar prej saj njerien, të cilën e quajti Eva. Kësaj Zoti i tha: - Ti je krijesë dytësore, jo e njëjtë me

Adamin. Je e detyruar t'i bindesh gjithë jetën atij, t'i shërbesh me besnikëri, ta dëgjosh dhe t'i bësh kalamaj sa herë t'i teket atij. Po të bëj pak më të shkurtër dhe më të dobët, që ai të ketë mundësi të të kontrollojë dhe të të hyjë në dru, po qe se i jepet rasti. Si kompensim, po të jap një llapë më të gjatë, që ta përdorësh si të të vijë për mbarë.

Eva nxori llapën dhe u bë gati të ankohej, por ishte vonë. Zoti qe zhdukur.

Dyshja

325 e.r.

Kur fliste gruaja e vjetër i mbante sytë mbyllur. Për të ndoshta ishte e vetmja mënyrë për t'u zhytur në thellësinë e mendimeve dhe për të nxjerrë që atje hollësitë e nevojshme, për të treguar. Ajo rrëfente me zë të njëtrajtshëm, pa emocion, sikur lexonte libër. Fjalët i shqiptonte qartë dhe shkoqur, pa u nxituar. Në fund të fundit, ato të dyja kishin kohë mjaftueshëm dhe asgjë nuk i nxitonte.

Vajza e ndiqte, edhe ajo me sytë mbyllur më të shumtën e kohës. Në fillim asaj i dukej mungesë mirësjelljeje t'i mbante sytë hapur kur tjetra fliste me sy mbyllur. Po t'i mbante hapur, ose do të shihte brenda kabinës së karrocës në të cilën udhëtonin, ose do ta hidhte vështrimin jashtë saj, në peizazhin njëtrajtshmërisht të mërzitshëm përreth. Brenda karrocës do të shihte ose të njëjtat dërrasa kufizuese dhe pëlhura zbukurimi, ose fytyrën symbyllur të bashkudhëtares. Jashtë, jo vetëm që do të shpërqundrohej, por edhe s'kishte për të përfituar gjë.

Jashtë ndriçonte vazhdimisht dielli, një diell përvëlues, një shkëlqim i njëtrajtshëm, që nga pika e mëngjesit deri në darkë. Ndërsa brenda karrocës ishte mugëtirë. Perdet e trasha lejonin vetëm dy-tri fije drite të depërtonin duke krijuar një gjysmerrësirë të butë, mpirëse. Gruaja e vjetër nuk shfaqte kurrë dëshirë për t’i lëvizur perdet. Dukej qartë se i pëlqente gjysmerrësira. Natyrisht, edhe freskia që vinte me të.

Me kalimin e kohës vajza vuri re se sytë e mbyllur e ndihmonin të përqendrohej. Gjithçka që gruaja e vjetër i tregonte, asaj i dilte përpara syve dhe i zhvillohej sikur po ndodhte në kohë reale.

Nganjëherë ato që dëgjonte dukeshin të paqarta. Vajza nuk arrinte të përcaktonte nëse gruaja e vjetër bënte humor apo e kishte seriozisht. As timbri, as volumi i zërit, as shpejtësia e shqiptimit të fjalëve nuk ndryshonin, për ta ndihmuar në të kuptuarit e nuancave të ironisë, sarkazmit apo thjesht shakasë. Asgjë nuk ndryshonte. Vetëm fjalët që thuheshin. Vajza ishte në mëshirë të fatit dhe të nuancave kuptimore të fjalëve. Megjithatë nuk ankohej. As sytë nuk i hapte, sepse e dinte që nuk kishte, për të pasur ndonjë lloj ndihme nga shprehja e fytyrës së gruas përballë.

Vajza e mbante edhe gojën mbyllur. Nuk pipëtinte. Vetë s’kishte ç’të shtonte, por as gruaja e vjetër nuk jepte shenja se kishte nevojë për mendimin e saj. Madje ajo nuk dukej sikur kishte nevojë as për nxitje. Nuk i duheshin as “ëhë”-të e as “e di”-të e rëndomta që, për njerëzit e tjerë, janë kripa e bashkëbisedimit.

Mbase e dinte që vajza përballë saj nuk kishte asnjë mundësi ta çonte mendjen gjetkë. Ose ishte e bindur se ato që po tregonte ishin aq të rëndësishme dhe tërheqëse, sa që kujt do që t'ia tregonte do ta bënte të dëgjonte me vëmendje të përqendruar. Po t'i shtojë kësaj edhe autoritetin e saj, jo vetëm si një zonjë e fisme shtatëdhjetepesëvjeçare, por edhe si gruaja më e fuqishme dhe më me ndikim në gjithë perandorinë, padyshim që do ta kuptojë se përse ndihej aq e sigurt.

Në dyshen brenda karrocës gjithçka ecte për bukuri.

Në fillim, në vazhdim

Vazhdon fillimi i kohës.

Njëkohësisht me pazarllëkun që bëhej në Kopshtin e Edinit, mijëra kilometra tutje, dy oqeanë dhe shtatë dete larg, Zoti përpiqej të arrinte një marrëveshje të ngjashme me Qygjin, në Kopshtin e bukur të S'Edinit, pranë vendit të bekuar të quajtur Xhyrë. Zoti kishte dhe ka aftësinë të ndodhet në dy ose më shumë vende të ndryshme në të njëjtën kohë, pasi për të, koha dhe hapësira nuk kanë pikë rëndësie, veçanërisht në rastet kur nuk duhet të kenë. Ndërsa kur duhet të kenë, kanë.

- O Qygj i shkretë, - i tha Zoti. - Ty të duhet një shoqe, sepse edhe emri që ke tingëllon shumë i vetmuar. Të duhet dikush që të të ndihmojë dhe ta ndihmosh. Një njeri tjetër, një njerie, me të cilën të shkëmbesh nja dy fjalë. Prandaj do të të shkul një brinjë.

- Kjo më duket ide shumë e mirë, - tha Qygji. - Vetëm, të lutem, mos më hiq brinjë. Brinjët dhembin.

Më shkëlqon ndonjë gjë tjetër që të ketë më pak dhimbje dhe të mos më prishë punë.

- Po çfarë të të shkëlqon? - pyeti Zoti?

- Ja, më shkëlqon apendicitin. Se ç'kam një parandjenjë që atë ma ke vënë kot.

- Hm, - ia bëri Zoti. - Të ditka bytha! Mos do të thuash se unë bëj gjëra kot, pa vlerë?

- Po edhe aq plot nuk duket se ke bërë, - tha Qygji, që donte të hiqej sa më i zgjuar dhe s'tregonte ndonjë shenjë të veçantë respekti për Zotin. Zotit nuk i pëlqente shumë ky qëndrim prej kapadaiu, por s'kishte ç'bënte. Në fund të fundit, vetë e kishte krijuar Qygjin kështu, shëmbëlltë të vetes së tij, fodull dhe kapadai.

- Apendicitin nuk ta heq sikur kaq ta bësh dhembin, - tha Zoti duke treguar gishtin e mesit, të cilin në atë çast e kishte nja tre kilometra të gjatë.

Qygji e pa me vëmendje gishtin dhe e kuptoi që ishte e pamundur ta bënte dhembin aq, prandaj filloi të vrasë mendjen, për të shkëlqur ndonjë pjesë tjetër të trupit.

- Po sikur të të shkëlqon një kockë nga ai zgjatimi në fund të barkut? Në fund të fundit, ai s'ka ç'të duhet me kockë, - i sugjeroi Zoti si pa e pasur shumë mendjen aty.

- Ky zgjatimi këtu? - tha Qygji duke ulur kokën. - Vërtet, as ky s'më hyn shumë në punë. Shkule të gjithin.

- Ndoshta të duhet kur pshurresh, - tha Zoti. - Që t'i japësh drejtimin e duhur dhe mos s'përkatësh.

- Ç'ia fut kot edhe ti, - tha Qygji. - Unë pshurrem shkurreve, ku të më zërë. Hiqe fare, se s'më duhet.

- Mirë, - tha Zoti i gëzuar. - Meqë nuk e dashke, po ta heq ty dhe po ia jap atij që do të krijoj. Që sot e tutje, ti do të jesh femra, ndërsa ai që do të krijoj do të jetë mashkulli.

Qygji s'e kishte fare idenë për çfarë flitej.

- Si të duash, - ia bëri, pa e vrarë mendjen fare.

Dhe kështu u bë. Zoti kreu operacionin e parë ndërgjinor duke e kthyer Qygjin në femër. Me këtë rast ai ia ndërroi edhe emrin nga Qygj në Qygje. Pastaj, Ai kreu përpunimin e dytë (ose, po të kemi parasysh njëkohshmërinë e veprimeve të Zotit, mund të themi të parë) gjenetik, duke krijuar një njeri nga penisi i një tjetri. Njeriun e porsakrijuar nga zgjatimi i tepërt i Qygjit e bëri mashkull. Pasi e krijoi, Zoti tha:

- Nisur nga prejardhja, mendoj që njeriu i ri i sapokrijuar të quhet Pallosh.

Qygjes iu duk i drejtë mendimi. Edhe Palloshit të sapokrijuar iu duk me vend.

Mëkati fillestar

Në anën tjetër, në Kopshtin e Edenit, Adami dhe Eva jetuan të lumtur dhe, në mes të të gjitha të mirave, deri atë ditën e mbrapshtë kur para tyre iu shfaq Gjarpri me propozimin për të ngrënë mollën e ndaluar. Duke pasur parasysh që mollët ishin tepër të rralla në Eden çifti origjinal u shty kollaj në ngasje. Me të ngrënë mollën e ndaluar, gjëja e parë që mësuan nga pema e dijes nuk ishte as shkrimi, as leximi, as matematika, as filozofia. Ishte seksi. Ata iu lëshuan njëri-tjetrit si të paparë dhe nuk iu ndanë për vite të tëra, derisa u kujtua t'u vinte Zoti për vizitë dhe t'i gjente duke ofsharë për ibret të Zotit. Ai mezi arriti t'i ndante dhe, duke iu bërëtitur, iu shpjegoi se kishin kryer mëkatin fillestar: seks me dashje para martesës.

- Çfarë është martesë?! - pyeti Eva që ndjeu se duhet të ishte diçka interesante.

- Është një ceremoni fetare në të cilën lidhen dy njerëz në bashkim të përjetshëm, - ia priti Zoti, pa u menduar se më vonë do të mund t'i dilnin probleme

me përkufizimin. - Megjithatë, unë s'kam ndër mend të merrem këtu me shpjegimin e martesës. Ju nuk duhet të kishit bërë seks përpara martesës dhe për këtë mëkat të pafalshëm dënimi është i formës së prerë: dëbim nga Kopshti i Edinit.

- Në rregull, - u hodh Adami dhe iu kthye përsëri Evës e vazhduan të bënin seks.

S'dihet përse po Zoti e kishte bezdi seksin e njerëzve. Ai e duronte atë te kafshët, ndërsa te njerëzit nuk e shihte dot me sy. Mbase, ngaqë i kishte krijuar ata sipas shëmbëlltyrës së tij dhe vetë nuk para bënte seks, sepse s'kishte me kë të bënte, me përjashtime të rralla, kur i dilte ndonjë virgjëreshë e martuar. Por kjo do të fillonte të ndodhte shumë më vonë. Ose, në fakt jo më vonë, por njëkohësisht, pasi për Zotin koha nuk ekziston. Fare mirë, Ai mund të ishte duke bërë seks për vete me atë virgjëreshën, ndërkohë që fliste me Adamin dhe Evën dhe ua ndalonte atyre seksin. Ndoshta kjo qe arsyeja që nuk i pëlqente seksi i njerëzve, shëmbëlltyrave të tij.

- Jo vetëm kaq, - tha ai me nerva të acaruar në kulm. - Që sot e tutje ju nuk do të jeni më të përjetshëm. Do të jeni të vdekshëm.

Adami dhe Eva e nuhatën që gjendja ishte serioze. Ulën kokat dhe kërkuan e gjetën nga një gjethe fiku për të mbuluar organet seksuale me to dhe pastaj u larguan gjithë turp nga Kopshti i Edinit.

Për mijëravjeçarë në vazhdim Kopshti i Edinit mbeti pa njerëz dhe pa mollë.

Adami dhe Eva u shpërngulën në pjesën lindore të Afrikës, ku u lanë të vërtiten mes kafshëve të egra, mes vështirësive dhe rreziqeve për ushqim. Jeta për ta bëhej çdo ditë e më e rëndë, ndonëse interesante. Sidoqoftë, duhet të ndiheshin të lumtur ngaqë, mbi të gjitha ishin të lirë të bënin seks dhe kjo nuk ishte pak. Paçka se, siç u mor vesh më vonë, seksi kishte kusuret e veta - filluan t'iu dilnin njëri pas tjetrit kalamajtë, të cilët, gjithashtu nuk të falnin për seks.

Në fillim, Adami me Evën u trembën. Kalamajtë që iu lindën ishin fëmijët e tyre dhe, për rrjedhojë, ata ishin vëllezër e motra. A ishte e moralshme që vëllezër e motra të bënin seks me njeri-tjetrin?

Për këtë ata iu drejtuan Zotit, por këtij nuk i kishte dalë ende inati.

- Bëni çfarë të doni, - iu tha. - Për mua s'ka pikë rëndësie. As që dua të merrem me ju. Do të shkoj të merrem me një çift tjetër njerëzish në Xhyrë të Librazhdit, të cilët janë ku e ku më të bindur se ju dhe dinë të dëgjojnë kur iu flet.

Kështu, Zoti i la të lirë vdekatarët e shkretë të Afrikës Lindore, të dëbuarit nga Kopshti i Edinit, Adamin dhe Evën, bashkë me kalamajtë e tyre të panumërt, që të bënin si të donin dhe të shumoheshin, sa të donin.

Këta nuk e humbën fare as rastin dhe as kohën. U shumuan, e u shumuan, aq sa s'i mbante dot më as Afrika Lindore, as ajo Jugore, as Afrika Veriore dhe as Afrika Perëndimore. Madje as Afrika Qendrore. Prandaj u detyruan të merrnin udhën dhe të përhapeshin nëpër botë, të pambikëqyrur nga Zoti, në qejf të vet dhe pa pikë kontrolli.

Karvani

325 e.r.

*Një do marrim, dy do lemë
Ku s'do shkojmë, ku s'do vemë,
Ku të shkojmë ta bëjmë shesh
Ku të vemë ta bëjmë përshesh.*

Vargu ecte ngadalë. Në krye, katër kalorës të armatosur deri në dhëmbë të Shkollës Palatine, gardës së re perandorake, që Konstandini i Madh kishte krijuar për të zëvendësuar Gardën Pretore të krijuar nga Augusti. Me gjithë vapën kalorësit mbanin përkrenaret e hekurta mbi kokë, ndërsa dy prej tyre - një në fillim dhe tjetri në fund të vargut, mbanin vertikalisht nga një shenjë kryqi. Pas katër kalorësve të parë vinin qerret e rënda, që romakët i quanin *plaustrum* dhe që transportonin ushqimet dhe pijet. Ato tërhiqeshin nga qe të fuqishme dhe lëviznin ngadalë duke i diktuar gjithë karvanit shpejtësinë, ose më saktë ngadalësinë e zhvendosjes. Pastaj vinte

një grup tjetër ushtarësh të Shkollës Palatine, njëzet a tridhjetë vetë, gjithashtu të armatosur. Ata i hiqnin rrugën dy karrocave luksoze, *carpentum*, të lëvizura nga kuaj të mëdhenj e të bukur. Ato ishin në të dytën, që ishte krejtësisht e mbuluar me dru të punuar imtësisht. Në të parën, hynte e dilte vazhdimisht Eusebio. Veç tij, në karrocën e parë ishin edhe disa arka të mëdha, të rënda, të mbushura me monedha - një thesar i vërtetë. Karroca ishte e stërmadhe dhe kishte vend edhe për arkat, edhe për Eusebion që, më së shumti kalëronte ose ecte në këmbë. Vend kishte dhe për atë që do të mbartej atje më vonë e që pritej të ishte më i madh se tri arkat dhe Eusebio të marra së bashku.

Dy karrocet shoqëroheshin në të dy anët me roja. Pas saj vinte grupi i shërbëtorëve dhe skllëvërve, pjesa më e madhe e të cilëve ecnin në këmbë. Në fund fare një njësit tjetër ushtarësh ruanin shpinën.

Herë pas herë në kabinën e mbyllur të *carpentumit* perandorak hynte ndonjë skllave për të kryer shërbimet e rastit - diçka të freskët për të pirë, fërkim shpatullash dhe nyjash këmbësh, fshirje djerse. Ato nuk rrinin gjatë, pasi Perandoresha parapëlqente të rrinte vetëm. Domethënë të rrinte vetëm me Afërditën. I vetmi burrë që hynte aty ishte Eusebio, i cili fliste gjithmonë me zë të ulët dhe me ton të njëtrajtshëm. Ai të linte përshtypjen e një njeriu, të cilit i mungonin ndjenjat.

Vajza përpiqej ta injoronte Eusebion po aq sa e injoronte edhe ai atë. Ajo gjithmonë e shihte me

admirim gruan e moshuar, ndjenjë kjo që nuk kishte të bënte edhe aq me statusin apo pasurinë e saj të pafundme. Prej kohësh Afërdita e kishte tejkaluar hutimin që të krijojnë pushteti i pakufizuar dhe pasuria e pamasë. Ajo ishte mësuar tashmë me to dhe i merrte si të mirëqena. Çka nuk e reshtte së mahnituri vajzën ishte forca fizike dhe mendore e kësaj gruaje, përmasat e njeriut me emrin Helena, që aty, një metër përballë saj, e linte trupin të lirë të tundej e të shkundej nga troshitjet e karrocës perandorake.

Karvani ndalej tri herë në ditë për nevoja personale dhe për ushqim. Për shkak të qeve ata nuk mund të bënin më shumë se njëzetë-njëzetepesë kilometra në ditë, dhe ndalesat bëheshin kryesisht pranë rrjedhave të ujit, përrenjve, lumenjve ose liqeneve të vegjël. Perandoresha nuk kërkonte ndalesa shtesë. Orari ndiqej me disiplinë të hekurt. Ushtarakët dhe skllevërit habiteshin me zonjën shtatëdhjetepesëvjeçare, durimi, energjitë dhe forca e së cilës ia kishte mohuar gjithë të tjerëve të drejtën për të rënkuar e për t'u ankuar. Që kur ishin nisur nga Bizanti, hm, nga Kostandinopoja, e deri aty pranë destinacionit të tyre, Jerusalemit, ajo nuk kishte rënkuar asnjëherë, nuk kishte shprehur asnjë shenjë lodhje.

Pjesën më të madhe të ditës, gratë e kalonin brenda kabinës dhe Afërditës i bënte përshtypje se si Helena rrallëherë merrte mundimin të hidhte sytë jashtë saj. Ndoshta kishte parë mjaft nga ai terren i shkretuar dhe nuk kishte asnjë dëshirë të shihte më. Tokë djerrë,

rërë e zhuritur, gurë të mëdhenj e të vegjël, përrenj gjysmë të tharë, pemë të leqendisura, tufa korbash që vërtiteshin kot, pa shpresë se do të gjenin gjë për të ngrënë.

Afërdita e dinte që karroca para tyre kishte hapësirë për thesarin e madh, të vërtetë, që do të sillnin nga Jerusalemi. Helena fliste shpesh për Kryqin e Shenjtë, Kryqin e Vërtetë, ndërsa Afërdita e dëgjonte e habitur.

- Nuk mund të ketë provë më të pakundërshtueshme se kryqi. Ai bënte jetën e një njeriu të thjeshtë, s'kishte as shtëpi, as pronë, as mall, që të linte pas. Ai nuk predikonte në asnjë tempull apo sinagogë, gurët apo pjesët e të cilëve të përdoren si relikte. Veshjet prej liri nuk mund t'i rezistojnë kohës. Varrin mund t'ia gjejmë, por jo eshtrat, pasi është ngritur në qiell. Dhe gurët e varrit nuk mund t'i marrim me vete. E vetmja gjë që mund dhe duhet të ketë mbetur prej Tij dhe që ne mund ta marrim me vete si dëshmi të jetës së tij është kryqi ku u ekzekutua - dy copa dru të kryqëzuara dhe ndoshta disa gozhdë, që kanë shërbyer për t'i mbajtur bashkë. Por edhe gozhdët që u përdorën për ta kryqëzuar...

Afërdita mendonte se ishte e pamundur që dy copa druri të kapura me gozhdë t'iu kishin rezistuar për treqind vjet elementëve. Edhe sikur të kishin mbetur, ajo nuk e përfytyronte dot sesi do të arrinte Helena t'i gjente dhe të përcaktonte që gjetja nuk ishte një ndër qindra apo mijëra kryqe të tjera të përdorura në shekuj për të kryqëzuar njerëz.

Helena e shihte me sytë e saj zhbirues dhe as që e ndiente të nevojshme t'ia dëgjonte pyetjet.

- Dëgjo me vëmendje çfarë të them unë dhe përpiku të kuptosh: Ne *na duhet* ai Kryq. Na duhet. Kyçi i gjithë muhabetit këtu është që *na duhet*. Dhe, meqë na duhet, do ta gjejmë. Më kupton? Unë nuk po e marr gjithë këtë rrugë në moshën shtatëdhjetë e pesë vjeç për t'u kthyer duarbosh. Do ta gjejmë patjetër. Do ta gjejmë edhe sikur nga fundi i dheut ta nxjerrim.

Afërdita nuk e vrau shumë mendjen. Ajo e kuptoi shumë mirë, prandaj nuk e pati aspak të vështirë ta shihte Helenën drejt e në sy pa iu dridhur qerpiku.

- Patjetër që do ta gjejmë, - tha.

Helena buzëqeshi. Çdo ditë e më tepër ajo bindej se s'ishite gabuar me këtë vajzë.

E zgjedhura

254 e.r.

*Ju që shpirtin ma mundoni,
Që s'më keni në kandar
Ju nga unë do ta pësoni,
Do t'iu djeg në shkrumb me zjarr.*

- Mama, përse quhet Njësh vendi ku jetojmë?
- Sepse nuk quhet Dysh.
- Përse nuk quhet Dysh?
- Sepse..., sepse nuk quhet Tresh? Apo ngaqë quhet Njësh?! Si thua ti?
- Mama, nga vjen fjala Njësh?
- Kuptohet nga numri një.
- Ç' do të thotë “një”, Mama? Përse themi “një”?
- Ja, këtë nuk e di dhe duhet ta mësoj nga një vajzë katër vjeçare.
- Ah, Mama, Mama. Qygjja ishte njeriu i parë që foli. Qygjja foli shqip, gjuhën e parë, nënën e gjuhëve. Qygjes i vinin fjalët vetvetiu - nuk kishte nevojë t'i kërkonte apo t'i mësonte nga njeri.

- E bëri Zoti me gjuhë të mësuar?
- Le të mos merremi me Zotin për një çast, se s'ka ndonjë lidhje me temën e bisedës. Kur Qygjja nisi të numërojë, nga thua ti do ta niste numërimin?
- Nga do ta niste numërimin? Ku ta di unë? Nga delet? Nga dhitë? Nga pemët përreth...
- Jo, Mama, jo. Do ta niste nga njerëzit. Njerëzit ishin më të rëndësishmit përreth. Nuk ishin as pemët, as delet dhe as dhitë. Do ta niste nga vetja e saj dhe nga Palloshi. Dhe meqenëse ajo kishte ardhur e para në këtë botë ajo e nisi nga vetja. Prandaj tha "Unë", ose "Në", ose "Një". Latinët e kanë shtrembëruar në *Unus*. Grekët e kanë spërdredhur në *Ena*. Njëshi i vërtetë është Unë. Siç është Dyshi - Ti.
- Çfarë?!
- Dyshi, fjala për numrin Dy. Kur Qygjja numëronte, kishte përballë Palloshin. I drejtoi gishtin vetes dhe tha "Unë", pastaj e drejtoi atë nga Palloshi dhe tha "Ti". Unë - ti. Një - di. Një - dy.
- Uau!
- Po, pastaj vazhdoi - Unë - Ti - Tjetri. Më vonë fjalën e fundit e shkurtoi. Unë - ti - tri. Një - dy - tri.
- Aha, po katër?
- Katër - katra është "ka të tjerë". Shkurt, katër.
- Ohu, ti të rokanis kokën. Nuk i dilet me ty, shpirt.
- Rokanis?! Mama, mua më pëlqen fjala rokanis. Shumë e bukur. Por unë sot po merrem me Unë, Një dhe Njësh. A s'të duket e çuditshme që të tria këto fjalë bashkohen në një të vetme dhe të tria vërtiten rreth meje?

- Jo, nuk më duket aspak e çuditshme. Të tria këto fjalë mund të bashkohen dhe të vërtiten në një të vetme për të gjithë banorët e Njëshit.

Helena u mendua një çast.

- Aha, kjo mund të jetë e vërtetë. Gjithashtu është e vërtetë që deri sot askujt tjetër përveç meje nuk i ka shkuar mendja për këtë. Ja, më thuaj ti, e kishe dëgjuar nga njeri tjetër këtë arsyetim? A të kishte shkuar ty vetë mendja për këtë përkim? Ti je grua e rritur, ke caq kohë që jeton këtu.

- Jo, të them të drejtën kjo është hera e parë që po e dëgjoj. Dhe duhet arsyetimi i një katërvjeçareje të ma sjellë në vëmendje.

- E shikon? A nuk vërteton kjo që “Unë” jam e veçantë? Unë jam njeri i zgjedhur. Jam zgjedhur pikërisht unë, që të jem njëshi, i lindur në Njësh.

- E kush të ka zgjedhur ty? Ty të kam lindur unë. Nuk të ka zgjedhur njeri.

- Se kush më ka zgjedhur mbetet për t’u gjetur në të ardhmen. Rëndësi ka që unë jam e zgjedhura. Dhe këtë e dini fare mirë ju të gjithë, edhe ti, edhe babi, edhe gjithë fisi. Unë vetë iu kam dëgjuar që thoni se unë jam e veçantë.

- Mos i bëj qejfin vetes kot. S’ke faj ti, ka faj yt atë që të rokanis kokën që në këtë moshë me gjithë ato gjëra - jo latinisht, jo greqisht, jo histori, jo matematikë, jo filozofi.

- Hm, interesant, ti e përdore përsëri fjalën “rokanis” brenda një kohe të shkurtër. Mbase fjala “rokanis” ka

edhe kuptim të mirë. Jo vetëm t’i ngatërron mendimet, por edhe ta vë mendjen në lëvizje. Dhe kjo është gjë e mirë, apo jo? Mendja në lëvizje është më pjellore sesa mendja e fjetur. Nxjerr më shumë ide. Edhe gjuhët e huaja të sjellin më shumë ide në kokë. Fillon mendon greqisht, ke ide të tjera, të lidhura me lashtësinë. Mendon latinisht ke ide moderne.

- Po kur mendon shqip?

- Shqipja është mëma e gjuhëve. Latinishtja dhe greqishtja janë thjesht bastardime të shqipes. Jo se shqipja nuk ka ndryshuar. Por ato, gjuhët e tjera, e kanë humbur kuptimin fillestar. Ndoshta shqipja duhet bërë përsëri gjuhë e të gjithëve.

- Mjaft tani, se po më tremb. I kalove shumë kufijtë e asaj që i lejohet të mendojë një kalama në moshën tënde.

- Hm, mosha. Mosha është thjesht konvencion. Ç’ka të bëjë mosha këtu?!

Ishte biseda e fundit që bënte me të ëmën, siç ishte edhe hera e fundit që e shihte atë. Pas kësaj, gjithçka ndryshoi. Ndër vite Helena mund të harronte shumë gjëra, por këtë bisedë do ta kujtonte fjalë për fjalë. E përsëriste në mendje në çastet më të vështira të jetës. E kthente dhe e rikthente në kokë madje që atë natë, kur e kishin zgjuar në pikë të errësirës dhe i kishin thënë të ndiqte pa bërë zë Gentin. E kishin veshur shpejt e shpejt, i kishin hedhur një pelerinë të madhe përsipër dhe e kishin ndihmuar të hipte në kalë, në mbrojtjen e atij burri të fuqishëm.

Pesë orë më vonë ajo ndodhej majë një kali të lartë, në krahët e fuqishëm të Gentit, besnikut të familjes, që e shtrëngonin fort për të mos e lënë të binte. Vajza e vogël dridhej pa lëshuar asnjë fjalë. E ndiente që diçka e rëndësishme, tepër e rëndësishme po ndodhte në jetën e saj. Nga thellësitë e barkut i vinte një ulërimë, një klithmë, një nevojë e brendshme për të kërkuar të ëmën ose të atin. Por truri ia ndalonte çdo pipëtimë. Genti i foli me pëshpërimë:

- Ti e kupton që nuk duhet të nxjerrësh zë?

Helena tundi kokën në shenjë pohimi. Genti nuk foli më, por i ngau kalit që të lëshohej sa më shpejt përpara. Ishte një natë dimri e errët, pa borë. Helena nuk kishte ftohtë. Kishte vetëm një ndjenjë dëshpërimi të pashpresë, të cilën e përjetonte ndoshta për herë të parë në jetën e saj. Ato katër vjet që kur kishte ardhur në këtë botë, ose të paktën ato dy vjet që kur mendonte se ishte bërë e vetëdijshme për çka ndodhte përreth saj, ajo nuk kishte provuar asnjëherë një trishtim të tillë. Të dy prindërit kishin bërë ç'ishte e mundur që asaj të mos i mungonte asgjë dhe, megjithëse të rreptë dhe ngulmues në kërkesat ndaj saj, ishin kujdesur ta mbanin vazhdimisht të lumtur. Ajo natë erdhi si rrufe në qiell të kthjellët.

Duhet të kishin arritur në majë të një kodre kur Genti mbajti kalin dhe u kthye pak mbrapa për të parë ç'bëhej. Aty, me sytë që i dilnin fare pak nga pelerina, Helena pa në largësi një ndriçim të madh, të frikshëm. Ishte zjarr. Vajza nuk pati nevojë t'ia shpjegonte

njeri që kulla e tyre, shtëpia më e madhe dhe më e rëndësishme e gjithë trevës po bëhej shkruamb.

- Mama... ba... - fjalët i shpëtuan me gjithë përpjekjen që bëri për të mos i shqiptuar.

Genti ia shtrëngoi dorën fort. Pamja e zjarrit filloi t'i vinte e shtrembëruar përmes lotëve, që ia kishin mbushur sytë.

Vonë, shumë më vonë, kur po zbardhej dhe duhet të ishin larg, ajo pyeti vetëm me një fjalë :

- Kush? - pyeti.

Genti, që nuk shquhej për elokuencë, u përgjigj edhe ai me një fjalë.

- Romakët.

Pastaj, me një ton çuditërisht të qetë, pa asnjë emocion njerëzor, fëmijëror, apo të çfarëdollojshëm, Helena shqiptoi qartë dhe prerë:

- *Siç na dogjën, do t'i djegim.*

Genti u mendua vetëm një çast. Ndoshta për të ishin të papritur edhe toni, edhe fjalët.

- *Siç na dogjën, do t'i djegim,* - përsëriti me të njëjtin ton, me të njëjtën vendosmëri.

Kali, kalorësi dhe vajza e vogël u kthyen dhe vazhduan rrugën drejt Jugut - drejt Luginës së Shkumbinit.

Tundimi

*Përmes grykës së Shkumbinit
Shtrihet Kopshti i S'Edinit
Kjo parajsë në mes malesh
Ngjitu-zbritu, s'di të ndalesh
S'di të ndalesh, ngjitu-zbritu
Ngjitu-zbritu, ha e dhitu.*

Zoti u përpoq të vinte në jetë të njëjtin plan edhe me banorët e Kopshtit të S'Edinit mes maleve të Xhyrës, në rrethinat e Librazhdit pranë Skampës, në luginën e Shkumbinit, në kërthizë të botës, në Ballkanin Perëndimor. Por banorët e parë të atyre trevave nuk e hëngrën atë koqe ulliri. Domethënë, nuk e hëngrën atë koqe molle. Kur iu afrua Gjarpri dhe filloi t'iu fliste Qygjja dhe Palloshi ishin ulur nën hijen e një peme e po bisedonin të shpenguar, të dy cullakë, siç i kishte krijuar dhe rikrijuar Zoti. Qygjja me një boshllëk në fund të barkut dhe Palloshi me një zgjatim që i ngjante shumë atij zgjatimi që kishte

pasur dikur Qygjja kur kishte qenë vetëm, por që tani nuk e mbante mend se kishin kaluar shumë kohë.

- A po mërziteni, o miq? - i pyeti Gjarpri me zë fishkëllyes.

- Ne nuk mërzitemi kurrë, - tha Palloshi. - Përderisa s'kemi asnjë punë për të bërë, nuk kemi as përse të mërzitemi. Mërzitet ai që ka punë. Ose mërzitet nga puna, ose mërzitet kur mbaron punën dhe s'ka ç'të bëjë.

Me këto fjalë të mençura Qygjja dhe Palloshi ia dhanë gazit për tri ditë rresht. Në fund të fundit, ata kohën e kishin me bollëk dhe s'kishin përse t'i vinin vetes kufizime kohore kur qeshnin. Gjarpri, i cili gjithashtu nuk dukej të kishte probleme të kësaj natyre, i priti me durim derisa mbaruan dhe vazhdoi krejt i qetë:

- Megjithatë, jeta mund të jetë edhe më interesante se sa të rrish pa bërë gjë.

- E ç'ka mund të jetë interesante se sa të rrish pa bërë gjë në përjetësi? - pyeti Qygjja. - Çfarë mund të jetë më interesante se sa mos kesh koqe pune për të bërë? Cila lloj jete mund të jetë më interesante se sa një jetë ku s'i thua asnjëherë punës "mirëmëngjesi".

- Një jetë me dije dhe njohuri, - tha Gjarpri. - Një jetë në kërkim të përgjigjeve për shumë pyetje që të lindin në kokë. Një jetë me emocione të reja që vijnë pas arritjeve të shumta.

- Për çfarë pyetjeje e ke fjalën? - ia priti Palloshi.

- Për shembull: Si u krijua njeriu? Përse ekziston bota? Sa larg janë yjet në qiell? Si mund të zbërthehet

atomi në grimca më të vogla? A e ka bërë pula vezën apo veza pulën?

- E kush e çan kokën të gjejë përgjigje për pyetje të tilla?! - ia pat Qygjja.

- Po edhe sikur ta çanim kokën, si mund t'i gjenim përgjigjet? - ia priti Palloshi.

- Fare e lehtë, - u hodh gjithë gëzim Gjarpri, të cilit iu duk se i dolën në shteg. - Mjafton të hani një kokërr nga ajo pema aty.

Qygjja dhe Palloshi i hodhën një sy një peme të bukur të mbushur me kokrra të kuqe për të cilën Zoti i kishte porositur që të mos e preknin me dorë se po ta preknin do t'i gjente belaja.

- Mos e fol, - ia priti Palloshi. - As që na vete mendja të hamë fruta. As zarzavate. Ne kemi mish me bollëk - pula, viça, derra, dele, keca, lepuj të butë dhe të egër, kemi mish kaprolli dhe fazani, breshka dhe bretkosa, kërmij dhe harabela. Ç'na duhet të hamë fruta?

Gjarpri i pa i çuditur. S'i kishte rënë kurrë rasti të merrej me njerëz të tillë.

- Po ju s'i keni provuar ato fruta. Provojini njëherë dhe do t'iu pëlqejnë. Veç kësaj edhe do t'iu mbushin me dije.

- Ik ore mbushu, se s'kemi nevojë as për dije, as për fruta, - ia priti Palloshi.

- Dhe meqë ra fjala e të provuarit, - tha Qygjja, - nuk kemi provuar ndonjëherë mish gjarpri. Dhe fap,

një të zgjatur dorën, e kapi Gjarprin dhe ia këputi kokën. Pas kësaj, ia hoqën lëkurën, e pastruan mirë e mirë, e vunë në tigan dhe e skuqën si ngjalë. Iu shijoi si kurrë ndonjëherë.

Ky veprim i dha Palloshit dhe Qygjes një farë përparësie në krahasim me dy të ngjashmit e tyre në anën tjetër të botës. Ata arritën të shmangin dëbimin nga Kopshti i S'Edinit në Xhyrë të Librazhdit. Kur erdhi Zoti që t'i vizitojë dhe t'i shohë ç'bënin, ai vuri re se pema frutore ishte e paprekur.

- Po Gjarpri ç'u bë?! - pyeti Zoti i çuditur.

Në fakt, asnjëherë nuk është marrë vesh se kush ishte, në të vërtetë, Gjarpri - ishte thjesht ndonjë agjent i fshehtë i Zotit, i dërguar posaçërisht për të provokuar çiftin e ri dhe për t'i shtyrë në ngasje që të hanin pemën e ndaluar me qëllim që të realizohej plani i fshehtë i Zotit për t'i dëbuar njerëzit nga kopshtet, apo ishte agjent i pavarur, provokator në profesion të lirë, që vërtitej sa në një kopsht të përsosur në tjetrin, duke u përpjekur të ngatërronte dynjanë dhe t'iu prishte të ardhmen njerëzve të pavdekshëm? Asnjë nga librat e shenjtë nuk jep sqarime të hollësishme rreth natyrës së lidhjeve shoqërore apo profesionale të Gjarprit me Zotin. Nga mënyra se si u soll Zoti *vis a vis* çiftit Pallosh-Qygje, mund të nxirret përfundimi se Ai (Zoti) duhet të kishte një farë dijenie për veprimtaritë e Gjarprit dhe, madje, ndiente edhe një farë përgjegjësie për sigurinë e tij.

Megjithëse jo shumë të ndërlikuar në lëmin e dijes (për vetë faktin që nuk kishin pranuar të hanin pemën e ndaluar), me atë budallallëkun e tyre, ose më saktë, me shejtan-budallallëkun e tyre, Palloshi dhe Qygjja e ndjenë që kështu duhet të ishte puna, prandaj nuk u përgjigjën menjëherë. Madje nuk u përgjigjën kurrë dhe Zoti as që kishte për ta marrë vesh në jetë të jetëve fatin e Gjarprit sikur Qygjja të mos kishte ulur kokën dhe mos e kishte ngulur vështrimin te një palë çizme të reja me lëkurë gjarpri që kishte veshur.

- Hmm! - ia bëri Zoti me vete. - Ata të Edinit, Adami me Evën, si mëkat fillestar zgjodhën seksin. Këta të S'Edinit paskan zgjedhur vrasjen dhe vjedhjen.

- Nuk e keni parë fare Gjarprin?! - gjëmoi Zoti.

- Jo, - u përgjigjën njëzëri Palloshi me Qygjen.

- Edhe gënjeshtren, - i shtoi Zoti me vete një të tretë listës së mëkateve fillestare të banorëve të Kopshtit të S'Edinit në Xhyrë të Librazhdit.

Për këto tre mëkate - vrasjen, vjedhjen dhe gënjeshtren Zotit iu ngritën nervat, ndonëse jo aq lart sa i ishin ngritur para disa kohësh në lidhje me mëkatin e seksit. Kjo u dëshmuar edhe në formën e dënimit që iu dha.

- Meqë nuk e keni ngrënë mollën e dijes dhe keni pranuar me vetëdije të plotë që të mbeteni në jetë të jetëve dhe brez pas brezi injorantë, nuk do t'iu dëboj nga Kopshti i S'Edinit, - tha ai mes brohoritjeve dhe duartrokitjeve të Palloshit dhe Qygjes.

Aq u entuziazmuan të dy banorët e Xhyrës, saqë Palloshi ngriti dorën dhe, ashtu duke qeshur, vërejti:

- Për më tepër kjo nuk është as mollë. Mua më duket më shumë si shegë.

Zoti e pa pemën me vëmendje dhe s'dihet përse i shpëtoi një - Ups! Por nuk e bëri veten.

- Megjithatë, - bubulliu duke vendosur një heshtje varri te dy të pranishmit, - kjo s'ndryshon asgjë. Pavarësisht mosngrënies së frutave të ndaluara, ju keni kryer tri mëkate të tjera fillestare dhe për këtë do të ndëshkoheni. Së pari, ju duhet të punoni, për të siguruar mirëqenien. Hajde shëndet!

Dhe u zhduk në qiell.

Palloshi dhe Qygjja mbetën vetëm. Nuk dinin ç'të thoshin. Fjala *punë* iu kishte rënë si bombë. Çdo gjë do ta kishin pranuar me qejf, po jo punën.

- Të thashë mos t'i vishje çizmet sot, - tha Palloshi.

- E ku e dija unë që do të vinte sot, - u justifikua Qygjja.

- Si tha, "duhet të punoni për të siguruar mirëqenien"?

- Po, kështu më duket se tha.

- Unë s'e kam fort qejf punën, - tha Palloshi.

- As unë, - ia priti Qygjja. - Puna s'ka asnjë lidhje me traditat tona.

- Por mbase është kështu: Po punove shumë, siguron mirëqenie të lartë. Po punove pak, ose po nuk punove fare ke më pak mirëqenie.

- E ç'na duhet mirëqenia a lartë? - ia priti Qygjja.
- Ne do të punojmë fare pak, sa për të siguruar një mirëqenie minimale. Sa për ta shtyrë. Pjesën tjetër të mirëqenies ose do ta vjedhim, ose do ta grabitim gjëkund. Të paktën na la këtu në Kopshtin e S'Edinit ku ke ç'të vjedhësh.

Dhe kështu e lanë që ata dhe, në jetë të jetëve, brez pas brezi, kushdo që do të vinte pas tyre, do të vazhdonin të punonin pak, fare pak, sa për të thënë, paçka se edhe mirëqenia që do të siguronin do të ishte e pakët, fare e pakët, sa për të thënë. Me sa duket edhe Zoti ishte në rregull me këtë zgjidhje. Atij nuk i bënte shumë përshtypje nëse njerëzit punonin apo s'punonin, kishin apo s'kishin mirëqenie, dinin apo s'dinin, mjafton që të vazhdonin ta respektonin dhe t'i luteshin Atij. Për të rëndësi parësore kishte seksi.

Pushim

*Lum për ty o i madhi Zot,
Ç'po këndojnë bylbylat n'mal!
Kan dalë fëmija e po lodrojnë,
Shpejt me u pa me shoqi-shojnë,
Me pa thanat si lulojnë,
Me pa ahet si gjethojnë!*

- Nuk duket se të parët tanë kanë pasur ndonjë respekt të veçantë për Zotin, - tha Afërdita me zë aq të ulët saqë mund të thoshe se fliste me vete. Megjithatë, edhe pa zë po të kishte folur, edhe vetëm sa ta kishte shkuar ndër mend atë mendim, Helena do të kishte qenë në gjendje t'ia kapte.

- Ndoshta, - tha ajo. - Ka shumë mundësi që mosrespekti të ketë qenë i dyanshëm.

- Ndërsa ti...

- Njeriu bën atë që duhet të bëjë, - Perandoresha nuk e la ta shprehte mendimin deri në fund. - Atë që duhet të bëjë dhe atë që është më e mira të bëjë në

rrethanat e caktuara. Unë kam një synim në jetë dhe jam skllave e atij synimi. Përballë përkushtimit tim për ta plotësuar atë synim gjithë të tjerat janë dytësore, të parëndësishme...

Porta e karrocës u hap dhe në të u shfaq koka e Eusebios.

- Përrua! - tha ai me zë fare të ulët. - Pushim!

Karvani u ndal. Perandoresha dhe Afërdita zbritën të dyja njëkohësisht nga karroca, e para, si gjithmonë, pa i dhënë as mundësinë më të vogël tjetrës që ta ndihmonte. Ato panë se kishin ndaluar përpara një përroi të madh, që fare mirë mund t'i thoshe edhe lumë po të kishe parasysh se sa të thata ishin ato anë. Uji vinte ngadalë duke krijuar pellgje të vogla që duhet të ishin të thella rreth gjysmë bojë njeriu. Ushtarët dhe skllëverit filluan të vinin kuajt në radhë për të pirë.

Të dyja gratë dhe, pas tyre edhe të tjerat nga pjesa e karvanit ku ishin shërbëtoret dhe skllavet, u ngjitën paksa përpjetë rrymës, siç ishte bërë tashmë e zakonshme. Burrat shkuan tatëpjetë. Një pjesë e grave, ndër të cilat edhe Helena, u ulën të kryenin nevojat rrëzë shkurreve. Afërdita dhe disa gra të tjera vazhduan drejt e te uji, hoqën pa ceremoni tunikat dhe, ashtu cullak, u lëshuan në një nga pellgjet. Aty në ujë mbaruan edhe nevojat e tjera. Burrat laheshin gati pesëdhjetë-gjashtëdhjetë hapa më poshtë. Të gjithë

e dinin se po të kalojë në dyzet gurë, uji pastrohet, prandaj asnjë nuk kishte qeder se ç' lëshonin gratë atje sipër.

Afërdita doli nga uji, kapi tunikën e mëndafshtë dhe me të në dorë u fut përsëri në ujë. Aty e zhyti të gjithin në ujë dhe pastaj e nxori dhe filloi ta shtrydhte fort. Ashtu të lagur e veshi mbi trup duke ndier kënaqësinë e freskisë që i sillte. Helena e ndiqte me bisht të syrit.

Gratë u kthyen në karrocë. Perandoresha u rehatua, e lëshoi trupin të lirë të kapte ritmin e lëkundjeve të karrocës, mbylli sytë dhe vazhdoi të zhytej në thellësitë e mendjes së saj.

Djegje

268 e.r.

Flakë dhe klithma. Errësirë që çirrej nga gjuhë të stërmëdha flakësh dhe shiu, shi i dendur, por i pafuqishëm. Trarët mbajtës dhe ata të tavanit kërcisnin si të çmendur nga përcëllima. Dy qen të mëdhenj stani hidheshin përpjetë si të tërbuar dhe sa s'po i shqyenin gurmazet me të lehurat e tërbuara, por pa arritur të shkëputeshin nga zinxhirët me të cilët ishin lidhur. Era ulërinte ndërsa currilat e shiut kullonin lirshëm, të pafuqishme përpara egërsisë së zjarrit. Shumë-shumë ato e shtonin tymin, një tym të zi, të trashë, mbytës.

Ajo rrinte strukur në një cep të dhomës së madhe dhe priste. Priste pa ditur ç'priste dhe pa asnjë ide ç'mund të bënte. I kishte ardhur fundi, vallë? Për të dalë as që bëhej fjalë - se daljen ia kishte zënë një tra i stërmadh i rënë nga tavani dhe i kthyer në prush përcëllues. Në këmbë nuk mund të çohet. As në gjunjë. Paksa po të ngrinte kokën i zihej fryma nga tymi. Rrinte shtrirë me hundën thuajse ngjeshur

përdhe duke e ndier se vetëm aty mund të kishte pak ajër të përshtatshëm për mushkëritë.

E trembte ideja e djegies së ngadalshme, por jo vdekja. Vdekja nuk e trembte. Madje, thellë-thellë e tërhiqte. E vetmja fije që e lidhte me jetën, ishte *ai*, figura e turbullt, e mistershme e atij djaloshi që çuditërisht ishte treguar i gatshëm ta dëgjonte e ta ndihmonte. I vetmi njeri në gjithë jetën e saj të trishtueshme, që kishte shprehur interes njerëzor për të, që kishte marrë mundimin t'i jepte këshilla dhe kishte premtuar ta ndihmonte.

Ku ishte tani? Mos ishte përpirë edhe ai nga flakët? Ajo rënkoi. Që kur ia kishte vënë flakën atij vendi të mallkuar, që kur e kishte përhapur prushin dhe zjarrin e vatrës, që kur kishte planifikuar se si do të kalonte nga një anë e odës së madhe në tjetrën, si do të përcillej në dhomat e fjetjes dhe në të gjithë hanin, ajo e kishte pasur më se të qartë se edhe vetë mund të ngërthehej nga ato flakë, po aq sa kishte qenë e bindur që ai do të shpëtonte.

Në fund të fundit, vdekja ishte më e mirë se ajo jetë e fëlliqur. Era e tymit të zi që të merrte frymën ishte lule në krahasim me erën e djersës dhe fëlliqësirës së trupave të palarë. Pesha e atij traut që pritej t'i binte sipër nga çasti në çast ishte më e mirëpritur se pesha e barqeve të lerosura që kishte qenë e detyruar të mbante sipër përsëri, e përsëri. Gjuhët e flakës ishin më durueshme sesa gjuhët e zilepsura të ushtarëve, që e lëpinin dhe i kallnin krupën. Dhe

gjithçka, edhe flakët, edhe tymi, edhe goditjet, madje edhe përdhunimet, ishin gaz dhe hare kur mendonte që përbindëshi i fëlliqur, jetënxirësi i saj tani ishte shkruar e hi.

Djaloshi e kishte ndihmuar me përgatitjen e zjarrit - lëvizjen e fuçive të vajit diku atje, përhapjen e shkarpace të pishës aty-këtu, lidhjen e qenve prapa shtëpisë. Të gjitha gjërat që ajo mund t'i bënte edhe vetë, por jo në një kohë aq të shkurtër dhe aq saktë. Ai kishte një disiplinë të çuditshme në veprime, si ushtar. Sepse ishte ushtar.

Ajo e kishte pranuar ndihmën e tij me një kusht - që ai t'i premtojte se do të largohej para se të binte nata, para se ajo ta vinte zjarrin. Nuk donte kurrsesi që ai të rrezikohej në ndonjë farë mënyre. As që ai të ishte i përfshirë në gjithë këtë histori. Kjo ishte puna e saj. Ishte hakmarrja e saj. Ishte jeta e saj dhe ajo po bënte atë që ajo e konsideronte si gjënë më të natyrshme për t'u bërë. "Është zjarri im, - i tha. - Atij që më shkatërroi jetën, atij që më hyri keq në hise, unë i vë zjarrin. Kaq."

Megjithatë, ai ishte kthyer dhe ajo ishte mahnitur nga ç'kishte parë ato sekonda para se ai tra i mallkuar të binte te dalja dhe t'i ndante nga njëri-tjetri. Pikërisht kur zjarri kishte filluar të kërciste mirë dhe kur ajo po sigurohej që ta përhapte sa më shumë në të katërta anët e bujtinës, sytë i kishin zënë siluetën e tij (ishte padyshim ai, për këtë ajo s'mund të gabohej) që vërsulej drejt ndarjes ku flinte përbindëshi. Për një

çast, për një çast të vetëm ajo ishte ndier e tradhtuar, pasi kishte kujtuar se ai po shkonte atje që ta shpëtonte atë mallkim. Por pastaj e kishte parë që kishin dalë të dy, ai duke i mbajtur në fyt shpatën atij njeriu të mallkuar. Ashtu i qetë, me ato lëvizjet e tij të prera, ai e kishte lidhur përbindëshin pranë një trari të madh, ndërsa flakët sa vinin e afroreshin. Nuk ishte tradhti. Sidoqoftë, ajo vetë kishte shtangur dhe nuk dinte si t'i shpjegonte veprimet e tij. Mbase ai po sigurohej që përbindëshi do të digjej pa asnjë mundësi që të shpëtonte. Por kjo s'kishte qenë fare pjesë e planeve të tyre fillestare.

Pastaj kishte ndodhur diçka që e kishte lënë pa frymë. Jo se e kishte mërzhitur apo trishtuar. Vetëm se e kishte habitur, në kuptimin më të mirë të fjalës. Aty të lidhur, me flakët që iu afroreshin dhe mes ca ulërimave të papërfytyrueshme, ai i kishte nxjerrë përbindëshit, një nga një, të dy sytë. Këlltap! Këlltap. Dhe ia kishte hedhur përdhe.

Pastaj ishte kthyer drejt saj me dorën e zgjatur. Ajo ishte matur të turrej drejt tij, por pikërisht në atë çast gjysma e çatisë kishte rënë midis tyre dhe ajo kishte mbetur e mbërthyer si në çark. Ndoshta edhe ai në anën tjetër.

Pas çdo çasti që kalonte, ajo vërente se ndjenjat po i mpiheshin dhe mendja e saj, zakonisht e mprehtë dhe e shpejtë, dukej sikur vepronte shumë ngadalë. Të paktën shumë më ngadalë në krahasim me kërcëllimën dhe përhapjen e flakëve përreth. Ashtu,

ngadalë, ajo solli edhe një herë përpara syve fytyrën e djaloshit, si për ta pyetur vetëdijen edhe një herë të fundit: “A je vërtet e sigurt që do të vdesësh? A e ke mbledhur mendjen që do t’ia lëshosh veten përfundimisht flakëve, apo do që të bëjmë edhe një përpjekje të fundit për të shpëtuar? Ndoshta ja vlen t’ai japësh edhe një mundësi të fundit atij...”

Ndoshta. Me siguri ia vlente. Por tani duhet të ishte tepër vonë dhe ajo s’mund të bënte gjë.

Dhe ashtu, pa asnjë shpresë, por edhe pa ndonjë dëshirë të madhe për shpresë, ashtu kot, sa për ta provuar një herë, ajo mori mundimin, hapi gojën, mbledhi të gjitha fuqitë që i kishin mbetur, thithi gjithë oksigjenin që mund të thithte mes atij tymi që sa vinte e trashej më shumë dhe lëshoi një piskamë të gjatë, një klithmë ndihme, që u ngrit përmbi flakët, përmbi kërcëllimën e trarëve të çatisë, që po bëheshin gati të binin, përmbi erën e tërbuar, që ulërinte grykës së Shkumbinit. Pastaj mbylli sytë dhe gjithçka u bë errësirë dhe heshtje.

Takimi

Koha: Ende shumë pranë fillimit të kohës

Pasardhësit e Adamit dhe të Evës vazhdonin të seksoheshin dhe shumoheshin pa pikë kontrolli dhe, sa herë që nuk i nxinte një vend, ose nuk iu mjaftonte ushqimi, hidheshin dhe përhapeshin në një vend tjetër. Jo vetëm kaq, por kur përtonin të lëviznin nga një vend në tjetrin ata mësonin se si t'i hidheshin në grykë njeri-tjetrit dhe t'ia shqyenin gurmazin, thjesht për të shkartisur dhe rralluar nga pak numrin, në mënyrë që ushqimi të dilte për të gjithë.

Kështu nisi procesi i shpërndarjes dhe krasitjes: Kërko vende të reja dhe vendosu atje. Gjej dikë që i ka zënë më parë këto vendet e reja, përvishu punës për t'i zhdukur nga faqja e dheut dhe për t'iu zënë vendin. Dhe, meqë kjo puna e shfarosjes së njëri-tjetrit erdhi një ditë dhe u bë si profesion parësor, më i rëndësishëm se të tjerët, ata iu vunë me zell kërkimit të rrugëve më të efektshme të shfarosjes, ndërlikimit dhe përsosjes së armëve së zhdukjes masive. Në fund

të fundit, nip-stërnipat e Adamit dhe të Evës e kishin marrë vesh se mbijetonte ai, i cili i kishte armët më të mprehta dhe arrinte t'ia shqyente më shpejt gurmazin tjetrit.

Ky lloj njeriu erdh' e u shtua në Afrikë, në Azi, në Oqeani. Duke u shtrirë dhe duke u përhapur, duke u zënë dhe duke u therur me njëri-tjetrin, duke iu shmangur njëri-tjetrit dhe izoluar për të mbijetuar, ata filluan të zhvillonin kultura dhe gjuhë të ndryshme. Aq të ndryshme, saqë s'merrnin më vesh ç'thoshte njëri e ç'donte tjetri. Jo se gjuha e përbashkët do t'i kishte ndihmuar shumë. Sidoqoftë, të gjithë ata, ku ishin e ku s'ishin, u shkëputën krejtësisht nga gjuha e tyre e parë, gjuha e Adamit dhe e Evës dhe krijuan një larushi të papërfytyrueshme formash dhe kulturash komunikimi, të përshtatura secila edhe me mjedisin ku jetonin e lëviznin. Përveç këtyre, duke u shumuar grupe-grupe, ata zhvilluan edhe tipare të veçanta dhe të dallueshme të ngjyrës së lëkurës, gjatësisë, formës së kokës, syve, buzëve, vetullave, flokëve, vitheve, gjokseve, kërcinjve të këmbëve. Këto tipare u bënë aq të ndryshme nga një grupim te tjetri, saqë ata filluan të mendonin se ishin edhe raca të ndryshme, pavarësisht se sa herë që iu tekej ta provonin, e shihnin se mund të përziheshin fare mirë dhe fare kollaj seksualisht me njëri-tjetrin. Sidoqoftë, kjo ideja e racave iu erdhi shumë për shtat pasi iu jepte gjithmonë të drejtën morale t'ia

mbështillnin me hu kokës njëri-tjetrit, t'i ngulnin thika pas shpine kujt të mundnin. Zoti nuk dukej se e kishte problem këtë.

E, meqë u përhapën në të katërta anët e tokës, ata s'kishin se si të mos përhapeshin edhe në Europë, në të gjithë Europën, në çdo cep të saj, duke përfshirë edhe cepat më të humbura, siç ishte pjesa Juglindore e Europës, gadishulli i bekuar i Ballkanit, ku vazhdonin të jetonin autoktonë, të pavarur, të papërzierë me racat e tjera të botës, të pashumuar, të paseksuar, dy njerëz të pastër dhe të kulluar, ashtu siç i kishte bërë drejtpërdrejt Zoti, pa asnjë ndërlikim intelektual, emocional apo sipërfaqësor, kolorit e trajtësor, Qygjja dhe Palloshi. Dy njerëz që flisnin gjuhën që iu kishte mësuar Zoti, pa e spërdredhur atë me trajta të çuditshme, pa i shtuar fonema dhe forma gramatikore të vështira, pa ia ngarkuar leksikun me nocione të reja dhe të panjohura, me ide të vështira që pasqyronin zhvillime të papara prej tyre.

Pra, erdhi një çast historik, një moment i zhvillimit të shoqërisë njerëzore, kur pasardhësit e Adamit dhe të Evës, brezat e rrjedhur prej tyre, që nga s'kishin bredhur nëpër botë pa iu zënë bytha vend, që s'kishin lënë njeri pa vrarë, pa prerë e pa përdhunuar, s'kishin lënë gjë pa provuar dhe zbuluar, shkatërruar dhe zëvendësuar u shfaqën në Kopshtin e S'Edinit në malet e Xhyrës, buzë lumit të bukur të Shkumbinit.

Ishin si ndonjë tridhjetë copë syresh, të palarë e të parruar, të pakrehur e të pahekurosuar, zhele-zhele

dhe me dhëmbë të shqyer, njerëz tipikë të epokës së gurit, gra, burra, pleq dhe fëmijë, që tërhiqnin pas ca mushka e gomarë të ngarkuar me plaçka, disa qen të mëdhenj dhe një tufë të vogël dhish që prishën qetësinë e amshuar të Maleve të Xhyrës me të palluarat, të lehurat dhe blegërimat e tyre. Pikërisht këta njerëz u ndodhën përballë Palloshit dhe Qygjes, të dy të pastër, si racë dhe si zhvillim mendor, të zhveshur ashtu siç i kishte krijuar Zoti, të panjohur me mëkatin fillestar, të paditur nga punët e botës përreth, dembelë dhe të pagdhendur, injorantë në kulm, të kënaqur me atë copë qiell që iu linin Malet e Xhyrës të shijonin, me ato fruta që mund t'i hanin në qejf të tyre, por që vazhdonin të mos i hanin, me ato kafshë që i shqyenin dhe i gllabëronin me ose pa gatuar.

Takimi i parë ishte tej mase i tendosur, të paktën nga ana e ardhësve, pasi këta e njihnin mirë rrezikun dhe të papriturat që mund t'i sillnin qokat me specie të njëjta. Ata nxorën menjëherë heshtat dhe thikat e gurit, u vunë në formacion luftimi dhe filluan të lëshonin ca hungërima të egra që të kallnin datën. Të gjithë, burra, gra, pleq, e fëmijë. Madje edhe gomarët e mushkat filluan të pëllasin e të përplasnin këmbët. Ndërsa Palloshi me Qygjen i shikonin me qetësi dhe kërkshëri. Disa nga këto kafshë të reja dukeshin shumë të ngjashme me veten e tyre. Së pari, ata s'kishin parë kurrë kafshë të tjera që të rrinin me dy këmbë - me përjashtim, tek-tuk, të ndonjë ariu. Por këta s'dukeshin shumë si arinj.

- Nuk janë arinj, - tha Qygjja. - Duken më të dobët dhe rrinë pa arsye mbi dy këmbët e pasme.

- E tmerrshme, - tha Palloshi. - Duken shumë si ne. Vetëm se ç'kanë ca si lëkura zhele-zhele sipër trupit.

- Disa prej tyre duken si gomarë, - vërejti Qygjja.

- Po, po, - tha Palloshi. - Disa të tjerë duken si mushka. Paskan edhe ca si dhi. Dhe plot miza.

- Mizat duhet të jenë të këtushmet, - tha Qygjja. - S'besoj se i kanë sjellë me vete.

- Mirë se vini në trojet tona autoktone, - iu drejtua krahëhapur Palloshi të porsaardhurve. - Ne të dy jetojmë këtu që në fillim të krijimit të tokës. Këtu na ka krijuar Zoti dhe këtu do të vazhdojmë të jetojmë autoktonë në jetë të jetëve, sa të jetë gjithësia. Ne flasim gjuhën e Perëndisë, gjuhën e Zotit. Po ju?

Të ardhurit rishtazi panë njëri-tjetrin në sy të çuditur. Iu dukej si gjuhë njerëzore, por s'po merrnin vesh asnjë fjalë. Sidoqoftë, toni i Palloshit nuk iu duk aspak armiqësor dhe kërcënues, prandaj sikur morën pak zemër. Edhe fakti që këta ishin vetëm dy, lakuriq dhe pa asnjë lloj vegle apo armatimi, sikur i qetësoi edhe më shumë. Filluan të flisnin me njëri-tjetrin me gjuhën e tyre të çuditshme, të pakuptueshme.

- Ne flasim gjuhën e Perëndive, - sqaroi edhe një herë Palloshi. - Po ju, çfarë gjuhe flisni?

Nuk dihet se si u përkthyen këto fjalë në veshët e të ardhurve, sepse ata u lëshuan sipër tyre si të tërbuar dhe, sa hap e mbyll sytë, e lidhën Palloshin këmbë e duar pas një peme, me surratin ngjeshur pas trungut.

Pa e bërë të gjatë vunë edhe Qygjen në rrëzë të një peme tjetër, por këtë e lidhën shtrirë në kurriz, me duart rreth pemës dhe me barkun përpjetë. Këmbët ia lanë të lira. Pastaj u mblodhën të gjithë në formë rrethi dhe filluan të flisnin për diçka që çifti autokton nuk po e merrte vesh ç' ishte.

Të dy të lidhurit u lanë ashtu gjithë natën, pa ushqim, pa sqarim.

Të nesërmen në mëngjes rishtarët meshkuj, domethënë burrat dhe disa nga pleqtë e porsaardhur, por jo fëmijët, filluan t'i hipnin me radhë përsipër Qygjes. Kjo nuk po merrte vesh ç'bëhej dhe nuk dukej se kundërshtonte. Por edhe sikur të donte të kundërshtonte, përsëri s'kishte shumë mundësi. Ndërsa Palloshi shihte me bisht të syrit i habitur. Përdorte bishtin e syrit jo për ndonjë arsye etike apo morale, por pasi pozicioni i tij me kokën ngjeshur pas trungut të pemës nuk i jepte këndvështrim tjetër. Si çift që s'kishin mësuar asgjë rreth mëkatit fillestar të seksit ata nuk ia kishin idenë ç'bëhej. Vetëm pas nja dy-tre orësh, kur iu shqyen këmbët dhe iu lodhën kockat, Qygjja filloi të rënkonte dhe të ankohej me zë të lartë, me klithma që mund të merreshin edhe si ulërime. Megjithatë, rishtarët vazhduan punën duke i lënë radhë njëri-tjetrit pa e prishur terezinë. Gratë e tyre, duke përfshirë edhe plakën, merreshin me gatime dhe me punë të tjera si mjelje dhish, mbledhje shkarpash, ndezje zjarri, apo qërim morrash e pleshtash. Rrallëherë i hidhnin sytë nga Qygjja dhe

personat që punonin sipër saj. Me sa duket as atyre nuk iu bënte shumë përshtypje kjo procedurë. Ose e konsideronin si punë për t'u bërë.

Kështu u mbyll dita e parë dhe Qygjja gjeti qetësi vetëm kur ra nata dhe të gjithë shkuan të flenë. Të nesërmen, që në pikë të mëngjesit, filloi i njëjti avaz. Po kështu edhe të pasnesërmen e me radhë. Intensiteti sikur ra, po puna vazhdoi. Me kalimin e ditëve edhe vetë Qygjja filloi ta shihte këtë si diçka që duhej bërë, prandaj edhe burrat e ardhur nuk e panë më të arsyeshme që ta mbanin të lidhur pas pemës. As atë, as Palloshin, i cili vazhdonte të mos shihte arsye për të kundërshtuar.

S'kaloi shumë kohë dhe në ato anë, domethënë në Kopshtin e S'Edinit, u shfaq përsëri për vizitë Zoti. Kur pa ç'bëhej me Qygjen ai u skandalizua. Gjeti rastin kur Palloshi dhe Qygjja ishin vetëm, pra kur nuk ndodheshin rrotull ardhësit dhe filloi t'iu ulërinte.

- Po ç'keni bërë kështu?! Jeni lëshuar si të tërbuar pas seksit. Si e keni ulur veten kaq poshtë në mëkatin fillestar?! Apo jo, - jo fillestar, sepse mëkat fillestar për ju është vrasja, pastaj gënjeshtria.

- Të betohem që s'kam bërë asnjëherë seks, - tha Palloshi, të cilin nuk ishte aspak e vështirë ta dalloje që thoshte të vërtetën.

- Unë s'desha, por ata më detyruan, - u justifikua Qygjja. - Unë as që e dija ç'ishte. Ata ma mësuam.

- Dhe ty të pëlqeu, - tha Zoti.

- Në fillim nuk më pëlqente fare, - tha Qygjja.

- Po pastaj?! - pyeti Zoti, i cili megjithëse ishte krejtësisht kundër seksit, nuk dihet përse kishte një kërshëri të papërmbajtur, për të marrë vesh gjithçka në lidhje me të.

- Pastaj, si të thuash, - tha Qygjja duke iu marrë goja. - Ca herë po, ca herë jo. Me ca më pëlqente, me ca të tjerë nuk më pëlqente. Sidomos me ata më të rinjtë, me trup të bukur e të lëmuar, me vithe të mbledhura dhe të forta dhe me...

- Mjaft e pandehur! - ulëriti Zoti, që e kishte marrë gjithë informacionin që i duhej. - Mjaft me këto perversitete. Do t'iu dënoj të dyve.

- Pse të dyve? - pyeti Palloshi. - Vetëm ajo e ka provuar seksin.

- Sepse jeni të dy si ekip. Dhe, sepse e kam më se të qartë që shumë shpejt do ta provosh edhe ti dhe ka për të të pëlqyer edhe ty, - tha Zoti.

- Po unë s'desha. Më kapën me zor.

- Deshe - s'deshe ti e ke fajin, - tha Zoti, i cili s'dihet se përse, por ka mbajtur gjithmonë një qëndrim të çuditshëm ndaj grave në çështjet e përdhunimeve, duke i dënuar viktimat më rëndë se përdhunuesit.

- Që sot e tutje të dy do të ktheheni në vdekatarë, si gjithë të tjerët. Mëkatarë - vdekatarë. Do t'iu le të vazhdoni të jetoni në të njëjtin vend, këtu në Kopshtin e S'Edinit, të cilin nuk do ta quajmë më me këtë emër, por thjesht do t'i themi Xhyrë, apo çfarëdolloj emri që t'iu shkrepet juve në mendje. Dhe do të jetoni këtu derisa të vdisni. Mëkatarë dhe vdekatarë. Pastaj, do

të shoh dhe do t'ua peshoj mëkatet në kandar me lutjet që keni bërë. Shëndet e bythë të forta! - Dhe, fap, u zhduk sa hap e mbyll sytë.

- Meqë qenka puna kështu, po bëj edhe unë seks, - tha Palloshi pa u menduar gjatë dhe u bë gati t'i lëshohej Qygjes.

- Dale, dale, ku shkon? - ia preu hovin Qygjja. - Kush të tha ty që kam qejf unë? Pse, vetëm ti e ke në dorë? Do bësh po të dua unë dhe kur të dua unë.

Palloshi mbeti si i hutuar, se nuk e priste që Qygjja, mikësja e tij më e afërt, partnerja e tij në të gjitha aventurat e zbulimit të mrekullive të Kopshtit të S'Edinit, shoqja, me të cilën kishte ndarë vetminë e qindra viteve, pjesëtarja e vetme e ekipit të tij sipas Zotit, t'i thoshte jo për një gjë kaq të thjeshtë. Ai e kishte parë me sytë e tij, që ajo kishte bërë seks me të gjithë meshkujt e fisit të porsaardhur, me përjashtim të një plaku që nuk bënte dot gjë dhe një djali të vogël që ende nuk ishte për atë punë. I shkoi një herë mendja t'i hidhej me dhunë, kundër dëshirës së saj, por Qygjja ia kuptoi mendimin dhe i hodhi një vështrim që atij ia kallkanosi gjakun. Palloshi e kuptoi se kështu, të palidhur, nuk mund ta nënshtrohte dot. Siç edhe e kuptoi që s'kishte se si e lidhte, pasi nuk mund t'ua kërkonte burrave të fisit të porsaardhur këtë nder. Prandaj filloi të hiqte dorë nga ideja e gabuar e seksimit me dhunë. Ndërroi taktikë dhe filloi ta merrte Qygjen me të mirë.

U desh një kohë e gjatë, tepër e gjatë që metoda e marrjes me të mirë të funksiononte, që Qygjja të pranonte dhe që Palloshi ta provonte për herë të parë kënaqësinë e seksit. Dhe, kur e provoi, s'kishte perëndi që t'ia mbushte mendjen të ndalej. Kërkonte përsëri e përsëri. Por Qygjja , e cila kishte mundësinë e variacionit dhe oreks seksual paksa më të kontrolluar se Palloshi, nuk mund t'i përgjigjej. Kështu që Palloshit s'i mbetej gjë tjetër veçse t'iu lëshohej grave të fisit të ardhur rishtas - që duhet thënë, se tashmë nuk ishin më rishtarë pasi kishte kaluar ca kohë qëkur ata kishin mbërritur në ato anë dhe s'kishin ndër mend të shkuleshin.

Afërdita

Koha: e papërcaktuar

Afërdita nuk kishte mbushur ende gjashtëmbëdhjetë vjeç kur përpara bujtinës së tyre ishte ndalur një *carpentum* i jashtëzakonshëm. Karroca si kjo, me emblema të praruara nga jashtë, me roja speciale dhe tufa sklleverish nuk ndalonin kurrë te Bujtina e Skampës. Ato fluturonin drejt Durrësit, ose në të kundërt, drejt Grykës së Shkumbinit. Afërdita ishte lindur dhe rritur duke luajtur buzë rrugës, duke ndier nga larg trokëllimën e patkonjve të kuajve mbi gurë, zhurmën e rrotave, kërcitjen e herëpashershme të metalit të armëve, llamburitjen nga larg të përkrenareve, zërat e ushtarëve dhe udhërrëfyesve. Ajo dinte të dallonte karvanin e tregtarëve nga tabori i ushtarëve, grupin e kalorësve në nxitim, nga zyrtarët e rëndësishëm që e merrnin rrugën më shtruar. Ajo ishte në gjendje të nisej nga zhurmat për të hamendësuar në shtatë raste nga dhjetë, nëse udhëtarët do të ndaleshin në bujtinën e tyre apo jo.

Deri para pak kohësh ajo dilte me të vëllanë buzë rrugës për t'iu shitur fruta atyre që s'kishin ndër mend të ndaleshin - shalqinj, fiq, kumbulla, bajame. Kur u rrit pak dhe trupi filloi t'i merrte forma femërore iu bë e qartë se mund të shërbente vetëm brenda në bujtinë - larje, shpëlarje teshash, pastrim dërrasash të dyshemeve, përgatitje zarzavatesh dhe mishi për gatim, përzierje pijesh, e plot punë të tjera.

Ditën kur *carpentumi* perandorak i Helenës u ndal në bujtinën e tyre i ati kërkoi që miqve të nderuar t'iu shërbente ajo, jo e ëma.

- Qysh të quajnë? - e pyeti Helena diku nga mesi i drekës. Afërdita u habit. Perandoresha jo vetëm që fliste shqip, por edhe i shqiptonte *q*-të dhe *y*-të si të kishte lindur në ato anë.

- Afërditë, - iu përgjigj vajza me gjysmë zëri.

- Bukur, shumë bukur, - kishte thënë zonja e madhe. - Afërditë. Emër dhe fjalë shqipe. Më pëlqen shumë. A e di ti ç'do të thotë Afërditë?

Vajza tundi kokën. Ajo s'para fliste shumë.

- Afërditë - pranë ditës. Është emri në shqip i yllit të mëngjesit dhe që e ka marrë gjithë bota. Të gjithë e quajnë "Afërditë". Oh, tani romakët kanë qejf t'i thonë Venus, por romakëve iu ka marrë koka erë dhe duan t'i bëjnë të gjitha ndryshe. Natyrisht, po i lamë ne.

Me këto fjalë, zonja u ngrit dhe vajti drejt kthinës së shtëpisë duke i bërë një shenjë të lehtë prindërve të Afërditës që ta ndiqnin. Afërdita dhe i vëllai shihnin paksa të hutuar, pa kuptuar për çfarë bëhej fjalë.

Pas nja dhjetë minutash ata u kthyen, nëna me sytë e ënjtur, sikur ta kishte goditur njeri. Megjithatë, ajo përpigjej të buzëqeshte.

Zonja iu drejtua Afërditës dhe e pyeti drejtpërdrejt:

- A do të vish me mua në Romë? Do të të marr me karrocën time. Bashkë do të shëtisim gjithë botën. Këtu mund të kthehesh dhe të vizitosh prindërit dhe vëllanë kur të duash. Si thua?

Afërditës i ndritën sytë. E si mund t'i thoshte “jo” një propozimi të tillë. Ajo pa nga e ëma si për t'i marrë leje dhe i gufoi zemra, kur kjo tundi kokën në shenjë miratimi. Pastaj ktheu kokën nga i ati, i cili i buzëqeshi, një buzëqeshje tejet e papërcaktuar, por sidoqoftë, një shenjë miratimi. I vëllai kishte shqyer sytë pa ditur ç'të bënte.

- Shko, bijë, - psherëtiu e ëma. - Me zonjën Helenë do të kesh një jetë shumë më të mirë. Dëgjoje mirë ç'të thotë ajo dhe përpigu të mos na turpërosh. Ajo do të të japë një jetë të re që as në ëndërr nuk e ke parë.

Ishin dashur vetëm katër ditë udhëtim, dy prej të cilave përmes Adriatikut, që Afërdita të përballej me madhështinë e Romës. Kurrë s'ia kishte marrë mendja që kaq shumë njerëz, me qindra e mijëra, ndoshta një milion, mund të jetonin në të njëjtin vend. Shëtiste e lumtur në Via Apia mbi gurët e së cilës lëviznin kuaj e karroca, shihte me kureshtje shtëpitë në anë të saj dhe të çdo rruge tjetër, kopshtet dhe parqet me lule e shatërvanë. Kalonte pranë banjave të Karakallës,

përmes Parkut të Akueduktit ku vetëm pamja e ujësjellësit e linte pa mend, hynte e dilte e frymëzuar nga arkitektura e Panteonit dhe vazhdonte ecjen drejt Forumit Roman me bollëkun e mallrave, që shiteshin e bliheshin çdo ditë nga mijëra njerëz. Shihte Circus Maximus, këtë arenë pa anë e pa fund, që dukej sikur mund të nxinte gjithë njerëzit e botës brenda dhe pastaj shëtiste midis vilave luksoze të aristokracisë në Kodrën Palatine, rrugët dhe parqet e së cilës ishin dëshmi e një pasurie të papërfytyrueshme. Adhuronte tempujt që s'numëroheshin të perëndive pa fund, statujat e mrekullueshme prej mermeri dhe nuk ngopej së vështruari kryeveprën e kryeveprave, gjigandin e gjigandëve, bukurinë e bukurive, Koloseun. Për të ishte përtej çdo përfytyrimi se si qeniet njerëzore mund të ishin në gjendje të ndërtonin një përbindësh të tillë.

Çdo ditë Afërdita kthehej në pallatin perandorak dhe i tregonte me entuziazëm Helenës ç'kishte parë dhe ç'kishte mësuar. Perandoresha e dëgjonte, buzëqeshte, por nuk fliste. Të nesërmen ajo e nxiste të dilte, të shihte, të mësonte e të tregonte të tjera gjëra. E nxiste të njihej me jetën e Romës, me të mirat dhe të këqijat e saj, me të varfrit dhe lypsarët që të sillnin zorrët te goja kur i shihje dhe me shkëlqimin e pafundmë të pasurisë, me luksin e veshjeve të mëndafshhta, me xhevahiret dhe zbukurimet e grave.

Afërdita u njoh me jetën e romakëve, me familjet e njerëzve të thjeshtë, me sklleverit, të cilët ishin

përgjithësisht robër lufte nga të katërta anët e perandorisë, si edhe me sklevërit e çliruar, të cilët gëzonin thuajse gjithë të drejtat si qytetarët e lirë, por përsëri trajtoheshin me përbuzje dhe kishin vështirësi për të mbijetuar. Pa lagjet e varfra, të mbushura me shtëpi publike, pijetore dhe pisllek.

Bazën e jetës së Romës e përbënte Forumi, vendi ku shkëmbehej gjithçka, jo vetëm mallrat e konsumit, sklevërit dhe kafshët, por edhe idetë filozofike, shkencore dhe politike. Aty njerëzit e të gjitha shtresave vinin për të marrë vesh ç'bëhej, për të dhënë mendimet e tyre, për të ndikuar në mënyrën se si qeveriseshin dhe ç'drejtim duhet të merrnin. Aty shihje edhe tregtarin injorant, edhe mendjet më të ndritura të shkencës, edhe politikanët më tinëzarë e më të sofistikuar.

Shumë shpejt Afërdita mësoi të dallonte rangun e njerëzve nga veshjet - të varfrit mbanin sipër tunikë me copë të ashpër, gjithmonë të errët në ngjyrë - për të fshehur papastërtinë, ndërsa patricët mbanin veshje prej leshi të bardhë të punuar hollë, ose prej mëndafshi. Zyrtarët e lartë dhe senatorët vishnin tunika me shirita të kuq që i quanin *tunica laticlavi*, ndërsa ushtarakët mbanin veshje shumë më të shkurtra se sa ato të qytetarëve të thjeshtë.

Përveç njerëzve që flisnin në Forum dhe që ajo i dëgjonte me kërshtëri, Afërdita nuk kishte ndonjë simpati për patricët me rroba të shtrenjta. Asaj nuk i pëlqente babëzia e tyre për të ngrënë, për

t'u argëtuar me çdolloj mënyre, për t'u lëshuar të shfrenuar pas shërbëtorëve e skllevërve, pas burrave e grave, pas kujtudo që t'i dilte përpara. I dukeshin bosh dhe pa vlerë. Por ama ata që flisnin në Forum e mahnitnin me njohuritë, me gjuhën e pasur, me nuancat filozofike, me thellësinë e mendimit. Aty shihje njerëz që demonstرونin arritje shkencore nga më të mrekullueshmet - mekanizma të ndërlikuara, kura mjekësore, studime mbi anatominë, zbulime astronomike. Gjeje poetë e prozatorë, historianë dhe analistë, këngëtarë dhe instrumentistë nga më virtuozyt. Por nuk mungonin as mashtruesit, fallxhorët dhe magjistarët, të cilët turma i ndiqte për një farë kohe me kërshtëri, por kur e kalonin masën i merrte përpara me të shara dhe me fyerje.

- Si po shkon eksplorimi i Romës? - e pyeti një ditë Helena.

- Shkëlqyeshëm, - përgjigjej Afërdita me vrull. - Këta muaj për mua kanë qenë një shkollë e vërtetë. Kam mësuar më shumë sa ç'dija gjithë jetën përpara se të vija këtu.

- Vërtet?!

Afërdita nuk e priste që bamirësja e saj të ishte e pakënaqur. Në fund të fundit, ajo vetë e kishte këshilluar që të dilte lirisht dhe të mësonte sa më shumë nga Roma.

- Mësoi mirë, - i tha një ditë Perandoresha, - dhe mundohu të mbash mend sa më shumë. Pasesër nisemi për në Bizant. Do të kalojmë përmes Athinës.